



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Ref. 01-Nr-052-2910

Ne baze te nenit 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” e në mbështetje të Raporti me numër të protokollit 01-Nr-052-2910 ,të datës 14.01.2025, i hartuar nga komisioni për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste në objektin afarist-banesor, sipas vendimit 01-Nr-410-61656, të datës 31.10.2024 dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-----, i datës 00.01.2025, Kryetari i Komunës, lidhë këtë;

M A R R Ë V E S H J E

Për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste për Komunën

Dispozitat e përgjithshme;

E hartuar me datën 14.01.2025, në Suharekë e lidhur në mesë palëve kontraktuese, si më poshtë:

I. PALËT KONTRAKTUESE:

1. Komuna e Suharekës të cilën e përfaqëson, **Bali MUHARREMAJ**,–Kryetar i Komunës, si dhënës i pronësi së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim afatgjatë nga njëra anë dhe
2. z. **Visar Sokol BASHA** i lindur me 02.09.1980 në Prizren, tani me vendbanim të përhershëm në Rr. “Nën Tereza” në Suharekë, përfitues-shfrytëzues i pronës së paluajtshme të Komunës, nga ana tjetër.

II. OBJEKTI I KONTRATËS:

Neni 1

Objekti i kësaj kontrate është ndarja dhe definimi i banesave dhe lokaleve afariste në objektin afarist-banesor që do të ndërtohet nga **Visar Sokol Basha** në pjesën e parcelës kadastrale **P-72116046-012110-0**, e cila i është dhënë në shfrytëzim me Vendimin e Kuvendit të Komunës në Suharekë 01-Nr-016-51843, të datës 30.08.2024 dhe sipas kontratës 01-Nr-016-55172 të datës 18.09.2024 për ndërtimin e objektit afarist-banesore.

Neni 2

Ndarja dhe definimi i banesave dhe lokaleve afariste është bërë nga Komisioni i themeluar nga Kuvendi i Komunës së Suharkës me vendimin 01-Nr-410-61657, të datës 31.10.2024

Neni 3

Sipas Raportit me numër të protokollit 01-Nr-052-2910, të datës 14.01.2025, i hartuar nga komisioni për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste në objektin afarist-banesor sipas vendimit 01-Nr-410-61656 të datës 31.10.2024, i cili raport është miratuar në Kuvendin e Komunës së Suharekës me vendimin 01-Nr-410----- me datën 00.01.2025, Komunës së

Suharekës në emer të kompensimit, për pronën e lartcekur që e ka dhënë në shfrytëzim i takon kjo sipërfaqe e banesave dhe lokaleve afariste si më poshtë;

Nr.	Katet	Nr. Baneses dhe lokalit	Hyrja	Sipërfaqja
1.	Përdhesa	Lokal 2-të	Lamela 2	95.98m ²
2.	Kati I-rë	Banesa A6	Lamela 2	116.67m ²
3.	Kati III-të	Banesa A6	Lamela 2	65.82m ²
4.	Kati IV-të	Banesa A7	Lamela 1	64.38m ²
5.	Kati I-rë	Banesa A1	Lamela 3	69.97m ²

Neni 4

Totali i sipërfaqes neto e banesave dhe lokalit afaristë do të jetë prej: 412.82m², e cila sipërfaqe i kopenzohet Komunës së Suharekës, në emer të pronës së lartcekur e cila i është dhënë në shfrytëzim investitorit të lartëceku dhe pasë nënshkrimit të kësaj marrëveshje nga palët dhe ndërtimit të objektit me metoda e sistemit “çelësat në dorë”, banesat dhe lokali i cekur më lartë regjistrohen në librin kadastral në pronësi dhe posedim në emer të Komunës së Suharkës, me adresë në Rr. Brigada 123”.

Neni 5

Çfardo ndryshimi që zona në fjalë në të ardhmen do të pësoj sa i përket planifikimit të PZHK-së, HZK-së dhe PRrH-së, apo aplikimit të Rregullores ose ndonjë akti administrativ për bonuset e zonimit, Komuna e Suharekës të kompensohet për vlerën apo pronen prej 27% të ndërtimit neto në banesa dhe lokale afariste.

Dispozitat e veçanta;

III. SHKËPUTJA E KONTRATËS

Neni 6

6.1 Në rast të shkëputjes së marrëveshjesë para skadimit të afatit, me marrëveshjen e palëve kontraktuese, obligimet e mbetura të do të rregullohen me marrëveshje të veçantë mes vet palëve kontraktuese.

6.2 Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësitë në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent për të vendos do të jetë Gjykata kompetente.

Neni 7

Çdo gjë që në këtë marrëveshje nuk është paraparë, atëher zbatohen dispozitat e LMD-së dhe rregullat e përgjithshme të se drejtes kontraktuese.

Neni 8

Kjo marrëveshje është përpiluar dhe nënshkruar në 5, (pesë) kopje të njëjta identike prej të cilave nga 2, (dy) kopje i takojnë secilës palë kontraktuese.

P A L Ë T N Ë N S H K R U E S E

Visar S. BASHA
Nr. Përs. 1002414593

Kryetari i Komunës
Bali MUHARREMAJ